



Portali

Bibla Shqip

Materiale

Apologjia

Fete & Kultet

Burime-Info

Kush Jemi

Abonohuni

Sthurrja e sotshme, sfidë për besimtarët...

Mediat herë pas here tregojnë për raste apo ngjarje të cilat ndodhin nëpër shkollat e mesme si dhe ato të larta shqiptare. Fatkeqësisht, shpesh dëgjojmë për studentë të cilët përdorin drogë ose që të paktën dëshmojnë se e kanë provuar. Ndërsa ngjarje të tjera tregojnë për sjellje dhe histori të cilat bëjnë bujë për shkak të detajeve me natyrë seksuale midis vetë të rinjve.

Një nga ngjarjet që u raportua kohëve të fundit nga mediat përmbante prova shqetësuese, jo vetëm thjesht për personat që merrnin pjesë në të, por akoma më tepër sepse ato ishin tregues të një realiteti të errët moral në të cilin gjendet rinia e sotshme.

Lexo me tej duke klikuar [KETU](#)

Mesazh Inkurajimi: Të ndërtojmë njëri-tjetrin

Si ta investojme jeten tone?

Te investosh do të thote të angazhosh një burim ose aset me shpresën e marrjes së një përfitimi në kembim. Për shembull në investojmë para në një biznes duke shpresuar një fitim.

Prinderit investojnë jetet e tyre tek femijet duke kërkuar pjekuri dhe gezim në jetet e tyre.

Jezus Krishti e investoi veten në jetet e 12 ndjekësve të tij në mënyrë që në kembim të kësaj ata të mund të dergoheshin për të investuar veten e tyre në jetet e shume të tjereve.

Plani i investimit të Perendisë gjithmone angazhon burimet e njerezve të Perendisë për të ndertuar njerezit e tjere në Krishtin.

Marrim rastin e Ananias i cili u dergua nga Zoti në rrugën e quajtur "E Drejte dhe në shtëpinë e Judes duhej të kerkonte një njeri nga Tarsi me emrin Saul... Ai ka parë në vegim një njeri të quajtur Anania që hyri dhe i vuri duart që të shikonte perseri". (Veprat e Apostujve 9:11-12)

Zoti i tha "Shko" dhe Anania shkoi. Ai rrezikoi veten e tij, ai e investoi veten në Saulin dhe Zoti sjell përfitimin në formën e shërbesës së madhe të apostullit Pal.

Te tjeret kanë investuar jetet e tyre shpirtërore në jeten tuaj shpirtërore. **A mund ti kujtoni keta emra?**

Ne çfare po e investoni jeten tuaj? Kush janë njerezit në familjen tuaj,

Vizioni ynë:

*"Që t'ju shërbejmë
shqiptarëve për
Krishtin."*

brenda kishes, ne vendin tuaj te punes dhe komunitetin tuaj tek te cilet ju po derdhni jeten tuaj dhe zemren ndersa i inkurajoni per tu rritur ne besimin ndaj Jezus Krishtit?

Jeni ju ata qe investoni. Zoti sjell shperblimin. **“Falas moret. Falas jepni”**
(Mateu 10:8)



albKristian.com

E-mail: bulletini@albKristian.com

Kush Jemi: [Stafi i albKristian.com](#)

Copyright © albKristian.com – Faqe te Krishtera Shqiptare

Bulletini albKristian.com eshte nje sherbese e albKristian.com – Faqe te Krishtera Shqiptare. Nuk lejohet asnje lloj perdorimi per qellime fitimi apo komerciale te cfaredo lloj forme. Mund te printohet, shperndahet dhe perdoret falas ose per qellime jofitimprurese pa lejen e autorit. Per cdo lloj perdorimi tjeter ju lutem na kontaktoni paraprakisht per leje.